



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, Ligjit për Zonat Ekonomike , nenit 10 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.10.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E**  
**DOKUMENTACIONIT PËR VENDOSJEN E BIZNESEVE NË ZONËN EKONOMIKE**  
**“PARKU INDUSTRIAL” NË QYLAGË –FAZA E DYTË**

**Neni 1**  
**Përbërja e Komisionit**

Formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit të pranuar nga bizneset afariste të cilat do të aplikojnë sipas konkursit publik për t'u vendosur në Zonën Ekonomike “Parku Industrial “ në Qylagë – faza e dytë ( në vazhdim të tekstit: Komisioni në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve:

1. Valon Pacolli nga ekzekutivi i komunës, kryesues
2. Latif Ramadani nga ekzekutivi i komunës, anëtar
3. Fitim Shala nga kuvendi i komunës, anëtar
4. Lulzim Rrustemi nga kuvendi i komunës, anëtar
5. Bekim Krasniqi nga shoqëria civile, anëtar

**Neni 2**  
**Mandati i anëtarëve**

Mandati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm vetëm për konkursin publik për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike “Parku Industrial” në ZK Qylagë- faza e dytë dhe brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

**Neni 3**  
**Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëjë shqyrtimin e dokumentacionit të pranuar nga bizneset afariste të cilat do të aplikojnë sipas konkursit publik për t'u vendosur në Zonën Ekonomike "Parku Industrial " në Qylagë, konform procedurave dhe kritereve të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Zonat Ekonomike dhe Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike, kritereve të përcaktuara në konkursin publik si dhe dispozitave tjera ligjore përkatëse.

**Neni 5**  
**Punët administrative - juridike të Komisionit**

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nënligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

**Neni 6**  
**Kompenzimi i punës së Komisionit**

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Konkursi publik do të kompenzohen në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse . Kompenzimi do të bëhet vetëm për anëtarët e komisionit të cilët nuk e kanë të ndaluar kompenzimin për kryerjen e shërbimeve shtesë konform dispozitave të legjislacionit në fuqi.

**Neni 7**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr. 15-020/04-61646

Lipjan, më 30.10.2023

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Daut Azemi**

